



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 101

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 18 qershor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 374, datë 5.6.2024	Për shpalljen e zonës, pasuria nr. 1/644, zona kadastrale 8210, si zonë në zhvillim, me qëllim ndërtimin e banesave sociale në pronësi të Bashkisë Tiranë..... 10863
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 105, datë 14.6.2024	Për delegimin e kompetencave..... 10863
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 14.5.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 101, datë 20.6.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 591, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të ekzekutimit të vendimit për regjistrimin e pronës sipas vendimit nr. 132, datë 14.2.1996, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier për aplikimin e bërë në datën 1.4.2015, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier. Cenimin e së drejtës së pronësisë, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës së Shqipërisë, nga DVASHK-ja, Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Fier dhe Avokatura e Shtetit..... 10863
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 129, datë 14.6.2024	Për delegim kompetence..... 10872
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 730/6, datë 13.6.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Përmet”..... 10872

**VENDIM****Nr. 374, datë 5.6.2024****PËR SHPALLJEN E ZONËS, PASURIA NR. 1/644, ZONA KADASTRALE 8210, SI ZONË NË ZHVILLIM, ME QËLLIM NDËRTIMIN E BANESAVE SOCIALE NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës, pasuria nr. 1/644, zona kadastrale 8210, në pronësi të Bashkisë Tiranë, si zonë e përshtatshme për zhvillim, me qëllim ndërtimin e banesave sociale, si pjesë e fondit publik të banesave sociale, në pronësi të Bashkisë Tiranë.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për financimin dhe ndërtimin e banesave të reja të përshtatura në apartamente, sipas normave të strehimit, në kuadër të strehimit social.

3. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

4. Ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë për përcaktimin e standardeve dhe të modaliteteve të realizimit të programit të zhvillimit të zonës me qëllim strehimin.

5. Ngarkohet Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR**Nr. 105, datë 14.6.2024****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për

organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, nga data 14.6.2024 deri më datë 19.6.2024, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Andi Mahila.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Andi Mahila.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

VENDIM**Nr. 39, datë 14.5.2024****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.5.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (L) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Laert Kola

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në mungesë; Zyra Përmbartimore Private “TDR GROUP” sh.p.k., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 101, datë 20.6.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



Konstatimi i cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 591, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave të ekzekutimit të vendimit për regjistrimin e pronës sipas vendimit nr. 132, datë 14.2.1996, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier për aplikimin e bërë në datën 1.4.2015, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier.

Cenimi i së drejtës së pronësisë, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës së Shqipërisë, nga DVASHK-ja, Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Fier dhe Avokatura e Shtetit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*) dhe Zyrës Përmbartimore Private “TDR Group” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 132, datë 14.2.1996, të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (*vendimi nr. 132/1996 i KKKP-së*) është vendosur, ndër të tjera, njohja e pronësisë së J. K. për një truall me sipërfaqe 5000 m², të ndodhur në fshatin Grecalli, komuna Qendër, Fier dhe kompensimi me truall fizik i trashëgimtarëve të tij ligjorë. Vendimi është regjistruar në regjistrat e kohës të zyrës së hipotekës Fier (regjistrat hipotekarë), ndërsa në datën 1.4.2015, kërkuari Laert Kola (trashëgimtar i të ndjerit J. K.) ka kërkuar (ri)regjistrimin e aktit të fitimit të pronësisë në

regjistrat e pasurive të paluajtshme. Në këtë rast, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZQRPP*), bazuar në ligjin nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me urdhrin nr. 664, datë 1.12.2015, ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se akti i fitimit të pronësisë (vendimi nr. 132/1996 i KKKP-së, Fier) nuk mund të regjistrohej në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pasi pasuria ishte regjistruar më parë në emër të Komunës Qendër, Fier sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 6.7.2011, (*VKM nr. 509/2011*).

2. Në datën 11.12.2015, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi, duke paditur ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier, si dhe duke thirrur si person të tretë Bashkinë Fier (së cilës i kanë kaluar të drejtat dhe përgjegjësitë e pronësisë së Komunës Qendër, Fier pas ndarjes së re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore). Ai ka kërkuar - konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, regjistrimin e pasurisë nr. 128/1, ZK 1453, terren sportiv, regjistruar sipas VKM-së nr. 509/2011 në emër të Komunës Qendër, Fier; - detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier (*ZVRPP, Fier*) të fshijë nga regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme subjektin Komuna Qendër, Fier për pasurinë nr. 128/1, ZK nr.1453, vol. 3, faqe 203; - detyrimin e ZVRPP-së, Fier të regjistrojë pronarët sipas vendimit nr. 132/1996 të KKKP-së, Fier për pasurinë nr. 128/1, ZK nr. 1453, vol. 3, faqe 203; - të shfuqizojë aktin administrativ të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nr. 128/1, ZK 1453, vol. 3, faqe 203 në emër të subjektit komuna Qendër, Fier dhe sigurimin e padisë.

3. Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 447, datë 31.3.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kërkuari ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 447, datë 31.3.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, mbi të cilin çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 9.9.2016. Në kushtet kur kjo e fundit nuk e kishte shqyrtuar çështjen ende, në datën 14.12.2020, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë sipas nenit 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) për konstatimin e shkellsë së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe



shpërblimin e dëmit. Me vendimin nr. 25/22, datë 17.6.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin për shpërblimin e dëmit, pasi ka vlerësuar se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit.

4. Në datën 12.10.2021, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 25/22, datë 17.6.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Me vendimin nr. 3, datë 17.2.2022 (*vendimi nr. 3/2022*), Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit, shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Në zbatim të vendimit të Gjykatës, Gjykata Administrative e Apelit ka gjykuar çështjen dhe në përfundim, me vendimin nr. 591, datë 7.12.2022 (*vendimi nr. 591/2022*), ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 447, datë 31.3.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar urdhrin nr. 664, datë 1.12.2015, të ZQRPP-së dhe urdhëruar të paditurin, ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier: i. të fshijë regjistrimin e pasurisë nr. 128/1, ZK nr. 1453, terren sportiv, në emër të Komunës Qendër, Fier sipas VKM-së nr. 509/2011; ii. të regjistrojë këtë pasuri në përputhje me vendimin nr. 132/1996, të KKKP-së, Fier. Në pjesën urdhëruese Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se vendimi përbën titull ekzekutiv dhe është menjëherë i ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Fier, ku mbi këtë bazë çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë. Nuk rezulton që kjo e fundit të ketë shqyrtuar çështjen dhe as të ketë vendosur për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit deri në shqyrtimin e rekurseve.

6. Pas përfundimit të procesit gjyqësor, kërkuari, në cilësinë e kreditorit, i është drejtuar shërbimit përmbartimor gjyqësor privat (zyrës përmbartimore “B.S.E. Bailiff Service Executive”, ndërsa më pas çështja i është transferuar zyrës përmbartimore “TDR Group”) për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit. Me shkresën e datës 30.1.2023, zyra përmbartimore ka lajmëruar debitorin, ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier dhe ASHK-në, Drejtorinë e Përgjithshme Tiranë për ekzekutimin vullnetar të detyrimit sipas titullit ekzekutiv, ndërsa në datën 13.2.2023, në mungesë të veprimit të debitorit, ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Ndërkohë, me shkresën nr. 1193/1 prot., datë 24.2.2023, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, i ka bërë me dije zyrës përmbartimore detyrimin për pagesën e tarifës së shërbimit. Me aplikimin nr. 5513, datë 27.2.2023, zyra përmbartimore i është drejtuar ASHK-së, Drejtorisë Vendore Fier, për regjistrimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe me shkresën e datës 3.4.2023 përmbartuesi e ka paralajmëruar atë se në rast mosekzekutimi të detyrimit do të vijohej me gjobitjen në respektim të nenit 606 të KPC-së, si dhe me kallëzim penal sipas neneve 320 dhe 320/a të Kodit Penal (KP). Në vijim, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, me shkresën nr. 2418, datë 5.4.2023, i është drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) për konfirmimin e vendimit nr. 132/1996 të KKKP-së, Fier, konfirmim i cili është bërë nga ATP-ja me shkresën nr. 1944/1 prot., datë 11.4.2023. Pavarësisht kësaj, me shkresën nr. 2458/1, datë 24.4.2023, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, i ka bërë me dije zyrës përmbartimore se pas konfirmimit të dokumentacionit nga ATP-ja do të procedonte me shërbimin e kërkuar në përputhje me ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”.

7. Në rrethanat kur debitori nuk po ekzekutonte titullin ekzekutiv, në datën 18.5.2023, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së ekzekutimit të vendimit nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe shpërblimin e dëmit si pasojë e mosekzekutimit të atij vendimi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së.

8. Me vendimin nr. 101, datë 20.6.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur



rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së ekzekutimit të vendimit nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, afat i arsyeshëm për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e nenit 399/1 të këtij kodi, do të konsiderohet afati njëvjeçar nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim, ndërkohë që në rastin konkret lajmërimi për ekzekutim vullnetar është bërë në datën 30.1.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në gjykatë në datën 18.5.2023.

9. Debitori, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, ka vijuar të mos ekzekutojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, ndërsa me shkresën nr. 5330/1 prot., datë 21.9.2023, i ka përcjellë ASHK-së, Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë, projektvendimin e refuzimit të regjistrimit sipas vendimit nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se pasuria për të cilën është disponuar me këtë vendim gjyqësor, në datën 30.12.2020, është regjistruar në emër të F.K. Apollonia sh.a. dhe kjo e fundit nuk është thirrur si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, ndaj ekzekutimi i këtij vendimi nuk mund të vijojë derisa aktet për kalimin e pronësisë në favor të këtij subjekti të shpallen absolutisht ose pjesërisht të pavlefshme.

10. Me kërkesën e datës 13.10.2023 kërkuar i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 7.12.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuar** ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

11.1 *Së drejtës për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë*, pasi nga momenti i ngritjes së padisë kanë kaluar afërsisht tetë vjet, ndërsa nga kërkesa për regjistrimin e pronës tetë vjet e gjashtë muaj. Megjithatë ai disponon një vendim të formës së prerë, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, është shprehur se nuk do të vazhdojë procedurën e regjistrimit të pronës, me argumentin se kërkuar i është drejtuar gjykatës dhe për sa kohë organi publik

që zhvillon procedurën përballet me çështje ligjore, e pezullon atë deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë. Ky argument është i gabuar, pasi kërkesa ka për objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për më tepër, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, padrejtësisht i jep të drejtë vetes të interpretojë një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të mos e zbatojë atë.

11.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi argumenti i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë se nuk është tejkaluar afati njëvjeçar i parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “c”, i KPC-së për paraqitjen e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm në procesin e ekzekutimit është tërësisht i gabuar dhe i njëanshëm, për sa kohë pika 2 e kësaj dispozite lejon paraqitjen e një kërkesë të tillë nga palët edhe pa kaluar një afat i tillë, kur pretendojnë zvarritje të ekzekutimit të vendimit.

11.3 *Së drejtës së pronës*, pasi megjithatë kërkuar i ndodhet në kushtet e një vendimi të formës së prerë, i cili i ka njohur titullin e pronësisë, organet shtetërore refuzojnë ekzekutimin e tij, duke e privuar nga gëzimi i pronës.

11.4 *Së drejtës së informimit*, pasi megjithatë që nga viti 2014 kërkuar i ka kërkuar informacion për pronën e tij, kjo e drejtë i është mohuar në të gjitha institucionet ku është drejtuar.

12. **Subjektet e interesuara, ASHK-ja dhe Zyra Përmbarimore Private “TDR Group” sh.p.k.**, nuk kanë paraqitur prapësime, ndonëse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo



rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë në proces, pikërisht në procedurën e ekzekutimit të vendimit nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, procedurë e cila nuk ka përfunduar dhe për të cilën ka kërkuar në Gjykatë konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutim brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimin e ekzekutimit, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive për çështje të mosekzekutimit në kohë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vlen të theksohet se, përpara ndryshimeve të KPC-së, Gjykata në jurisprndencën e saj të mëparshme ka trajtuar drejtpërdrejt ankime të kësaj natyre (*shih vendimet nr. 35, datë 18.4.2017; nr. 6, datë 23.2.2016; nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë, me ndryshimet që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 38/2017*), të cilat kanë hyrë në fuqi më 5.11.2017, ligji procedural ka parashikuar tashmë mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm. Në referim të këtyre ndryshimeve ligjore, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, afat i arsyeshëm për qëllimet e përcaktuara në nenin

399/1 të këtij kodi, për sa i përket ekzekutimit të një vendimi civil ose administrativ të formës së prerë, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, si rregull, konsiderohet afati njëvjeçar, që fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim. Ndërsa neni 399/6 i KPC-së, për çështjet në ekzekutim, përcakton se gjykata e shkallës së parë kompetente për ekzekutim, është kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e ekzekutimit.

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pas vendimit të formës së prerë të datës 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, që konsiderohet nga ligji si titull ekzekutiv, kërkuesi në datën 30.1.2023, i është drejtuar shërbimit përmbarrimor gjyqësor privat për vënien në ekzekutim të tij. Në vijim, në datën 18.5.2023, ai ka paraqitur kërkesë në gjykatën kompetente të ekzekutimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, përsheptimin e procedurës së ekzekutimit dhe shpërbllimin e dëmit si pasojë e mosekzekutimit të atij vendimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 101, datë 20.6.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se në rastin konkret nuk ka kaluar afati i arsyeshëm njëvjeçar sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së nga momenti i vënies në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

18. Në këtë kuptim, në këndvështrim të këtyre dispozitave ligjore, në rastin konkret Gjykata vlerëson se megjithëse kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë përpara plotësimit të afatit të përgjithshëm njëvjeçar të përcaktuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “c”, i KPC-së, kjo kërkesë është në vijim të një procesi gjyqësor për të cilin atij tashmë i është njohur nga Gjykata shkelja e afatit të arsyeshëm dhe urdhëruar përsheptimi i procedurës së gjykimit të themelit të çështjes. Nisur nga kjo, rezulton se përmes mjeteve juridike të mbrojtjes që KPC-ja ka ofruar për garantimin e së drejtës për proces të rregullt në procesin gjyqësor në të cilin janë vënë në diskutim të drejtat të tij të lidhura me ushtrimin e një të drejte substanciale, siç është ajo e pronës private, kërkuesi ka kërkuar që të mbrohet edhe në procedurën e



ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të dhënë në atë proces gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Kërkesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 20.6.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur fillimisht në datën 13.10.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

20. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, së drejtës së pronës dhe së drejtës së informimit janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, bazueshmëria në themel e këtij pretendimi do të analizohet në vijim, ndërsa ai përfshihet në juridiksionin kushtetues në këndvështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm

21. Kërkesi ka pretenduar se nga momenti i ngritjes së padisë kanë kaluar afërsisht tetë vjet, ndërsa nga kërkesa për regjistrimin e pronës tetë vjet e gjashtë muaj. Megjithatë ai disponon një vendim gjyqësor të formës së prerë, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, është shprehur se nuk do të vazhdojë procedurën e regjistrimit të pronës, me argumentin se kërkesi i është drejtuar gjykatës dhe për sa kohë organi publik që zhvillon procedurën përballet me çështje ligjore, e pezullon atë deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë. Ky argument është i gabuar, pasi kërkesa ka për objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në lidhje me procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për më tepër, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, padrejtësisht i jep të drejtë vetes të interpretojë një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të mos e zbatojë atë. Edhe argumenti i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë se nuk është

tejkualuar afati njëvjeçar i parashikuar nga neni 399/2 i KPC-së për paraqitjen e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm në procesin e ekzekutimit, është tërësisht i gabuar dhe i njëanshëm, pasi pika 2 e kësaj dispozite lejon paraqitjen e një kërkesë të tillë nga palët edhe pa kaluar një afat i tillë, kur pretendojnë zvarritje të ekzekutimit të vendimit. Kërkesi ndodhet në kushtet e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili i ka njohur titullin e pronësisë, ndërsa organet shtetërore refuzojnë ekzekutimin për regjistrimin e tij, duke e privuar nga gëzimi i pronës së tij.

22. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

23. Gjykata ka theksuar se parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142, pika 3, të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufij për realizimin e saj (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ai përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 25, datë 27.3.2017; nr. 1, datë 21.1.2016; nr. 35, datë 27.10.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se një individ, i cili ka qenë palë fituese në një proces gjyqësor me një autoritet publik, mund t'i kërkojë të ndërmarrë disa hapa proceduralë për të lejuar ose përshpejtuar zbatimin e një vendimi. Megjithatë, kërkesa për bashkëpunimin e kreditorit nuk duhet të shkojë përtej asaj që është rreptësisht e nevojshme dhe nuk i liron autoritetet nga detyrimet e tyre (*shih Burdov kundër Rusisë (nr. 2), datë 15.1.2009, § 69*). Barra e



provës për të siguruar zbatimin e një vendimi kundër shtetit u takon autoriteteve shtetërore (*shih Yavorinskaya kundër Rusisë, datë 21.7.2005, § 25*). GJEDNJ-ja ka theksuar se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk duhet të jetë e tillë që të cenojë thelbin e së drejtës së mbrojtur sipas nenit 6 § 1 (*shih Burdov kundër Rusisë, datë 7.5.2002, § 35; Androsov kundër Rusisë, datë 6.10.2005, § 52*). Refuzimi i autoriteteve shtetërore për të zbatuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e lartë - që mund të çojë më pas në një sërë vendimesh në kontekstin e të njëjtit grup procedurash, duke shfuqizuar vazhdimisht vendimet e dhëna - është gjithashtu në kundërshtim me nenin 6 § 1 (*shih Turczanik kundër Polonisë, datë 5.7.2005, §§ 49-51*).

25. Për sa i përket kohëzgjatjes tërësore të çështjes, Gjykata konstaton se kërkesëpadia e kërkuarit drejtuar gjykatës me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të refuzimit të regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë, fshirjen e regjistrimit të pasurisë në emër të Komunës Qendër, Fier dhe regjistrimin e pronarëve të saj sipas aktit të fitimit të pronësisë, është paraqitur në datën 11.12.2015. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 447, datë 31.3.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 591/2022, e ka ndryshuar atë vendim, duke vendosur pranimin e kërkesëpadiës. Ky vendim i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë pas vendimit të Gjykatës nr. 3/2022, me të cilin është konstatuar cenimi i së drejtës së kërkuarit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në datën 30.1.2023, kërkuari i është drejtuar shërbimit përmbartimor privat me kërkesë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe në vijim, në datën 18.5.2023, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkesë kjo që është rrëzuar me vendimin nr. 101, datë 20.6.2023, të asaj gjykate.

26. Në kuptim të rrethanave të mësipërme, Gjykata vëren se gjykimi i çështjes së kërkuarit ka zgjatur rreth shtatë vjet e tre muaj, kurse nga momenti kur ai ka paraqitur kërkesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (data 30.1.2023) dhe deri në paraqitjen e kërkesës

para kësaj Gjykate (data 13.10.2023) kanë kaluar më shumë se nëntë muaj, ndërsa deri në momentin e shqyrtimit të saj kanë kaluar më shumë se 15 muaj. Pra, procesi në tërësi po vijon tashmë prej më shumë se tetë vjetësh e pesë muajsh. Referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, afat i arsyeshëm për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1 të këtij kodi, për sa i përket ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ të formës së prerë, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, si rregull, konsiderohet afati njëvjeçar, që fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim. Ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6, pika 1, i KPC-së edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit. Nisur nga fakti se kërkesa e paraqitur në Gjykatë nga kërkuari është në vijim të vendimit të saj në të cilin është konstatuar cenimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndërsa në lidhje me ekzekutimin ai pretendon zvarritjen e procedurës nga organi publik debitor, ka vend për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas rrethanave të rastit konkret dhe në referencë të kriterëve të pranuar në jurisprudencën kushtetuese e konkretisht në lidhje me: i. sjelljen e kërkuarit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari.

27. Në lidhje me *sjelljen e kërkuarit*, Gjykata vëren se pas vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit të datës 7.12.2022, kërkuari ka paraqitur kërkesë për ekzekutimin e atij vendimi në datën 30.1.2023. Gjatë procedurës së ekzekutimit nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, në përgjigje të kërkesës së datës 24.2.2023, të ASHK-së, Drejtorisë Vendore Fier, ai ka përmbushur në datën 27.2.2023, edhe detyrimin për pagesën e tarifës së shërbimit në këtë institucion. Gjithashtu, kërkuari i është drejtuar disa herë ASHK-së, Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë dhe Ministrisë së Drejtësisë, duke u ankuar në lidhje me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuari, në



cilësinë e kreditorit, ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij dhe ka përmbushur në kohë çdo detyrim procedural, ndaj sjellja e tij nuk rezulton të ketë përbërë shkak për zvarritje të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

28. Edhe për sa u përket veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, rezulton se me shkresën e datës 30.1.2023, ai ka lajmëruar debitorin, ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier dhe ASHK-në, Drejtorinë e Përgjithshme Tiranë për ekzekutimin vullnetar të detyrimit sipas titullit ekzekutiv, ndërsa në datën 13.2.2023, në mungesë të veprimit të debitorit, ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Po ashtu, në përgjigje të kërkesës së ASHK-së, Drejtorisë Vendore Fier, përmbaruesi ka bërë aplikimin e kërkuar dhe ka derdhur pagesën e tarifës së shërbimit në llogari të këtij institucioni. Gjithashtu, me shkresën e datës 3.4.2023, përmbaruesi ka paralajmëruar ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier, se në rast mosekzekutimi të detyrimit do të vijohet me gjobitjen në respektim të nenit 606 të KPC-së, si dhe me paraqitjen e kallëzimit penal sipas neneve 320 dhe 320/a, të KP-së. Në vijim, ndërsa çështja përmbarimore me kërkesë të kërkuarit është transferuar në një tjetër shoqëri përmbarimore, me njoftimin e datës 12.6.2023, përmbaruesi i ka kërkuar përsëri debitorin, ASHK-së, Drejtorisë Vendore Fier, të ekzekutonte vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në këtë kontekst faktesh, pavarësisht mosndërmarrjes së veprimeve shtrënguese të paralajmëruara, Gjykata vlerëson se përmbaruesi gjyqësor privat ka realizuar hapat e nevojshëm proceduralë për ekzekutimin në kohë të vendimit gjyqësor të formës së prerë, ndaj edhe sjellja e tij nuk rezulton të ketë përbërë shkak për zvarritje të ekzekutimit.

29. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, me të cilin debitori, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, është ngarkuar me detyrimin për të fshirë regjistrimin e pasurisë nr. 128/1, ZK nr. 1453, terren sportiv, në emër të Komunës Qendër, Fier dhe për të regjistruar këtë pasuri në përputhje me vendimin nr. 132/1996, të KKKP-së, Fier. Gjykata vlerëson se kjo çështje, pikërisht detyrimi sipas titullit ekzekutiv, nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë zgjatjen prej

disa muajsh dhe tashmë prej më shumë se një viti të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

30. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë faktin se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës, Gjykata vlerëson të shqyrtojë sjelljen e autoriteteve publike të përfshira në këtë proces. Kështu në lidhje me ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier, debitore në procedurën e ekzekutimit, Gjykata konstaton se ajo në datën 5.4.2023, i është drejtuar ATP-së me kërkesë për konfirmimin e vendimit nr. 132/1996, të KKKP-së, Fier, ndërsa në datën 24.4.2023, ka njoftuar përmbaruesin gjyqësor privat se pas marrjes së këtij konfirmimi nga ATP-ja do të procedohej me shërbimin e kërkuar sipas ligjit, në një kohë kur ATP-ja ia ka përcjellë konfirmimin e kërkuar me shkresën nr. 1944/1 prot., datë 11.4.2023. Në vijim, në kuadër të trajtimit administrativ të një ankese të kërkuarit, me shkresën nr. 3846/1 prot., datë 14.6.2023, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, ka informuar Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion dhe për dijeni edhe kërkuarin në lidhje me procedurën e ekzekutimit, duke bërë të ditur se në kushtet kur pasuria për të cilën është disponuar me vendimin nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit në datën 30.12.2020 është regjistruar në emër të F.K. Apollonia sh.a. dhe kjo e fundit nuk është thirrur si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, ekzekutimi i këtij vendimi nuk mund të vijonte derisa aktet për kalimin e pronësisë në favor të këtij subjekti të shpallëshin absolutisht ose pjesërisht të pavlefshme. Kurse me shkresën nr. 5331/1 prot., datë 21.9.2023, mbi të njëjtin qëndrim, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, i ka përcjellë ASHK-së, Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë, propozimin për refuzimin e regjistrimit sipas vendimit nr. 591/2012, të Gjykatës Administrative të Apelit. Ky propozim është kthyer për rishikim, saktësim dhe plotësim nga ASHK-ja, Drejtoria e Përgjithshme Tiranë, me shkresën nr. 2570/19 prot., datë 13.11.2023. Pas kësaj nuk ka të dhëna për vijimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga debitori, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier.

31. Për sa më lart, Gjykata konstaton se pavarësisht paraqitjes së kërkesës, në datën 30.1.2023, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe



plotësimi të kërkesave formale si ajo e pagimit nga kërkuesi të tarifës së shërbimit në datën 27.2.2023 dhe marrja e konfirmimit të datës 11.4.2023, nga ATP-ja në lidhje me vendimin nr. 132/1996 të KKKP-së, Fier, institucioni publik debitor ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, përgjatë një periudhe disamujore dhe tashmë prej më shumë se një viti, nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit. Për më tepër, neni 142, pika 3, i Kushtetutës parashikon detyrimin e organeve të shtetit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, ndërkohë që ekzekutimi në rastin konkret lidhet pikërisht me shërbimin publik për të cilin debitori është ngarkuar nga ligji, i cili përcakton një afat 15-ditor për trajtimin e kërkesave për shërbim kadastral, afat ky që në çdo rast nuk duhet të kalojë 21 ditë kalendarike (neni 29, pika 3, i ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”). Vlen të përmendet se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor në këtë rast nuk rezulton të vijë për shkak të ndonjë paqartësie të vendimit, që do të bënte objektivisht të pamundur regjistrimin e pasurisë sipas urdhërimit të tij. Duke mos vepruar përgjatë një periudhe të tillë kohore për marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, autoriteti shtetëror në rastin konkret ka zhveshur garancitë e nenit 42 të Kushtetutës nga çdo lloj efekti të dobishëm. Mosrespektimi i një vendimi gjyqësor nga organi shtetëror të cilit i drejtohet, përbën shkelje të vetë thelbit të procesit të drejtë dhe të parimit të shtetit të së drejtës. Organi shtetëror nuk mund të refuzojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë mbi pretendime rreth diskutueshmërisë së vendimit nga pikëpamja e së drejtës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se sjellja e autoriteteve shtetërore nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke çuar në zvarritje të pajustificuar të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

32. Gjithashtu në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, Gjykata vëren se në rastin konkret pretendimet e kërkuesit, në thelb, lidhen me ushtrimin e së drejtës së pronësisë për një pasuri të paluajtshme, njohur trashëgimlënësit të tij me vendimin nr. 132/1996 të KKKP-së, Fier dhe në vijim konfirmuar e drejta për regjistrim në regjistrin

publik me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndonëse çështja e kërkuesit nuk ka të bëjë me ndonjë të drejtë ngushtësisht vetjake, Gjykata vlerëson se ajo është e lidhur me ushtrimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Nisur nga veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në moszbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por dhe faktit se është konstatuar më parë cenimi i afatit të arsyeshëm gjatë procesit në gjykatat e zakonshme, Gjykata çmon se çështja është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

33. Gjykata thekson, gjithashtu, domosdoshmërinë e përsheptimit të procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe, për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ajo çmon se duhet urdhëruar institucioni publik i ASHK-së për të përfunduar ekzekutimin e vendimit nr. 591/2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,¹

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 101, datë 20.6.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuesit Laert Kola për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e kërkesës sipas objektit të saj, përveç pikës 4 të dispozitivit, për të cilën vlerësoi të panevojshëm urdhërimin e ASHK-së për

përfundimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke qenë se 3 pikat e para të dispozitivit në vetvete riparojnë të drejtën e kërkuesit të pretenduar si të cenuar.



formës së prerë nr. 591, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

4. Urdhërohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës të përfundojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 591, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 14.5.2024.

Shpallur, më 11.6.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

URDHËR

Nr. 129, datë 14.6.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Negociimit dhe Asistencës Ligjore, znj. Denada Dosti.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, do të ushtrohen për periudhën nga data 17.6.2024 deri më datë 21.6.2024, nga dita e hënë deri ditën e premte.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti, drejtor i Drejtorisë së Negociimit dhe Asistencës Ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Kastriot Gurra

KËRKESË

Nr. 730/6, datë 13.6.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ‘Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Përmet’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Përmet.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Përmet, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 940 800 (nëntëqind e dyzetë mijë e tetëqind) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, QYTETI PËRMET”, BASHKIA PËRMET

Nr.				Të dhëna hipotekore (sipas kartelës së pasurisë)									Vlerësimet për shpronësim												Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasuritë etj.)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Trrall (m²)	Volumi	Faqe	Arë			Trrall			Pa frut (pfi)			Ndërtesë				Vlera totale (lekë)	
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)			
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	X	Y	Z		
A																											
	PRONË SHITET			Përmet	1589	26/9	Ledh	600	-	-	2	16	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Pratit shpat	
B	TRASHEGIMTARËT IBRAHIMI																										
	1	GEZIM	MEHDI	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/2	Arë	4000	4000	-	2	9	3,490	112	390,880	-	-	0	-	-	0	-	-	0	390,880	Diferencë prej 580 m² shpronësuar më parë
	2	KAPLAN	MEHDI	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/2	Arë																		Bashkëpronësi 1/5 e pasurisë	
	3	ABAZ	MEHDI	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/2	Arë																		"	
	4	ZEGJAVETE	MEHDI	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/2	Arë																		"	
	5	BAHRIE	MEHDI	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/2	Arë																		"	
C	TRASHEGIMTARËT IBRAHIMI																										
	1	DRITË	ISMAIL	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/10	Arë	2860	2860	-	2	240	2,854	112	319,648								0	319,648	Bashkëpronësi 1/8 e pasurisë	
	2	ILIRIAN	SOTIR	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/10	Arë																		"	
	3	ANDREA	SYRJA	RANGA	Përmet	1589	26/10	Arë																		"	
	4	ANILA	KRISTUL	DHIMITRI	Përmet	1589	26/10	Arë																		"	
	5	MARIA	SOTIR	NIKOLLA	Përmet	1589	26/10	Arë																		"	
	6	MERHEME	SYRJA	MARKU	Përmet	1589	26/10	Arë																	"		
	7	ROBERT	SYRJA	IBRAHIMI	Përmet	1589	26/10	Arë																	"		
D	8	VALENTINA	SYRJA	JACE	Përmet	1589	26/10	Arë																	"		
	TRASHEGIMTARËT KARAFILI																										
E	1	MITORE	IBRAHIM	MEMISHAJ	Përmet	1589	26/12	Arë	2854	2854		2	242	2,056	112	230,272								0	230,272	Diferencë prej 789 m² shpronësuar më parë	
	2	ZUBIDIE	IBRAHIM	BEJTIA	Përmet	1589	26/12	Arë																		Bashkëpronësi 1/21 e pasurisë	
	3	GEZIM	HALIL	MANCELLARI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	4	ERMIRA	HALIL	MUKA	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	5	SHPETIM	HALIL	MANCELLARI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	6	SHPRESA	HALIL	XHIKA	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	7	FATBARDHA	KAMBER	HOXHIA	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	8	VLADIMIR	SABAUDIN	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	9	BESNIK	SABAUDIN	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	10	FATOS	SABAUDIN	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	11	SHPRESA	SABAUDIN	LICO	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	12	MIMOZA	KAMBER	MIDHA	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	13	LILJANA	KAMBER	SEFERI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	14	PELLUMB	KAMBER	MANCELLARI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	15	BARDHYL	KAMBER	MANCELLARI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	16	SANIJE	GANI	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	17	AGRON	RIFAT	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	18	AGIM	RIFAT	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	19	IBRAHIM	EQEREM	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	20	LORETA	EQEREM	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
	21	PAQE	METE	KARAFILI	Përmet	1589	26/12	Arë																		"	
													8,400		940,800	0.0		0	0		0				940,800		



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 64 lekë